

VENDIM
Nr. 157, datë 9.7.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “BLAC ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË NGA HEC “BLAC”, ME FUQI TË INSTALUAR 1300 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; si dhe të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.7.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Blac”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Blac Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 379 prot., datë 10.5.2018, ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Blac”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 119, datë 4.6.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Blac”, me fuqi të instaluar 1300 kw.

- Në vijim të këtij vendimi, me shkresën nr. 55/33 prot., datë 8.6.2018, u botua në median e shkruar njoftimi për fillimin e kësaj procedure.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, në lidhje me paraqitjen e objeksioneve dhe ankesave nga të tretët, nuk rezulton të jenë paraqitur të tilla në lidhje me këtë aplikim.

- Shoqëria “Blac Energy” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar me qëllim kryerjen e veprimtarisë, me objekt financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e HEC “Blac” dhe transferimin e HEC-it tek autoriteti kontraktues në përfundim të afatit të kontratës së koncesionit të formës BOT, me nr. 578 rep. dhe nr. 269 kol., datë 14.10.2015, të lidhur ndërmjet saj (shoqërisë) në cilësinë e koncesionarit dhe autoritetit kontraktues, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si dhe kontratës shtesë së koncesionit, me nr. 241 rep. dhe nr. 87 kol., datë 5.4.2016, të lidhur ndërmjet të njëjtave palë.

- Fuqia e instaluar e HEC “Blac” do të jetë 1,300 kw.

- Aplikimi i shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Blac Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

nga HEC “Blac”, me fuqi të instaluar 1300 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti